



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

STATUTI



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Statusi juridik**

Albanian University (këtu e vazhdim AU) është person juridik, i organizuar si Institucion jo Publik i Arsimit të Lartë, me statusin e Universitetit që financohet nga burimet e veta të brendshme, dhe burime të tjera të ligjshme.

Albanian University e ka selinë e saj qendrore në Tiranë. Dega e saj e cila është pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore, ushtron veprimtarinë në Berat.

Veprimtaria e Albanian University bazohet në Kushtetutën e R.SH (nenin 57, pika 6,7), në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” (këtu e në vazhdim Ligji Nr. 80/2015), në Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” në këtë Statut si dhe në Rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Albanian University është vazhdues i Universitetit UFO (UFO University), themeluar me Vendimin nr.197, datë 10.04.2004 të KM, dhe riorganizuar me Vendimin nr.603, datë 24.03.2011 të KM.

Albania University ka stemën dhe vulën e tij, të cilat i bashkangjiten si Aneks këtij Statuti.

Neni 2 **Misioni i AU**

Misioni i AU është:

- a. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- b. të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- c. të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- d. të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;
- e. të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;
- f. të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- g. të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- h. të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tij;
- i. të mbështesë dhe realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkim shkencor.

Neni 3
Standartet bashkëkohore

Arsimi i lartë në AU zhvillohet në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës, si dhe duke respektuar Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standartet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (këtu e në vazhdim HEAL).

Neni 4
Autonomia institucionale

AU është institucion autonom. Në kuadrin e kësaj autonomie AU i njihet e drejta e:

- a. vetëqeverisjes për të organizuar strukturat e brendshme dhe veprimtaritë e këtyre stukturave nëpërmjet këtij Statuti dhe Rregulloreve, të hartuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- b. hartimit dhe zhvillimit të pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;
- c. përcaktimit të kriterëve të veçanta të pranimit të studentëve në programet e studimeve;
- d. vendosjes së lidhjeve me shkollat e larta vendase dhe të huaja për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në mësimdhënie, në kërkimin shkencor si dhe për kualifikimin e personelit;
- e. vendosjes së marrëdhënieve dhe anëtarësimit në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të shkollave të larta si dhe bashkëpunimin me subjekte, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e Universitetit;
- f. lëshimit të diplomave, certifikatave apo titujve të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer;
- g. kryerjes së vetëvlerësimit në funksion të realizimit të qëllimeve dhe të detyrave të tij institucionale;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- h. administrimit të fondeve e të ardhura të tjera, që disponon sipas legjislacionit në fuqi;
- i. aktivitetit botues në përputhje me nevojat e procesit mësimor e të kërkimit shkencor;
- j. përzgjedhjes të personelit të tij.
- k. konkurrimit me projekte me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e kërkimit shkencor.

Neni 5
Liria akademike

AU gëzon liri akademike në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në krijim, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015.

Liria akademike qëndron në respektimin e shumëllojshmërisë së opinionëve, të ideve e metodave, dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe të shërbimeve në përputhje me standardet e HEAL.

Neni 6
Paprekshmëria territoriale

Të gjitha mjediset ku ushtron veprimtarinë e tij AU, në zbatim të nenit 5, germa dh) të Ligjit Nr. 80/2015 gëzojnë paprekshmërinë.

Cënimi i paprekshmërisë së AU, ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e AU bëhet vetëm me kërkesën ose lejen e Rektorit.

Vetëm në rastet e kryerjes së një vepre penale flagrante, në rastet e fatkeqësive natyrore apo gjendjes së jashtëzakonshme, organet e rendit publik kanë të drejtë të ndërhyjnë edhe pa lejen e Rektorit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

KREU II

ORGANIZIMI I UNIVERSITETIT

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. AU në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ofron studime me kohë të plotë në të tre ciklet e studimit:
 - Bachelor;
 - Master (Master Profesional; Master i Shkencave);
 - Doktoraturë;si dhe kurse të tjera specializimi dhe kualifikimi.
2. Arsimiti në AU organizohet i koordinuar në përputhje me kërkesat e zhvillimit kombëtar, dhe në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit.
3. AU përgatit specialistë të rinj përmes tre ciklesh të arsimit universitar nëpërmjet programeve të tij të studimit dhe specializimeve në fushën e stomatologjisë dhe në fusha të tjera në përputhje me programet e studimit që ai ofron dhe në funksion të kërkesave të tregut të punës.
4. AU ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS).
5. Programet e studimeve hartohen nga njësitë përbërëse të AU dhe miratohen nga Senati i tij.
6. AU shpall publikisht titujt e diplomave, ciklet e studimit dhe programet e tyre, para aplikimit të kandidatëve për pranim në të.
7. AU realizon kërkim shkencor me anë të njësive kryesore dhe bazë.
8. AU ofron shërbime për të tretët, në përputhje me misionin dhe me statusin juridik të tij.

Neni 8

Arsimimi dhe kërkimi me interes të përbashkët

1. AU mund të kryejë veprimtari arsimimi me interes të përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera akademike, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike ose private.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

2. AU mund të kryejë veprimtari kërkimore-shkencore të niveleve të ndryshme dhe me interes të përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera si universitete, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike ose private.
3. Në zbatim të nenit 80 të Ligjit Nr. 80/2015, AU mund të ofrojë edhe programe të përbashkëta studimi.
4. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Neni 9

Njësitë përbërëse të AU

1. AU bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 , me anë të këtij Statuti si dhe të Rregulloreve që hartohen në përputhje me të, përcakton organizimin e brendshëm të tij.
2. Pranë AU funksionojnë këto njësi përbërëse:
 - a. Njësi kryesore është *Fakulteti*.
 - b. Njësi bazë është *Departamenti*.
 - c. Njësi ndihmëse dhe shërbimi në funksion të njësive kryesore dhe bazë janë edhe: *laboratorët, klinika stomatologjike universitare, biblioteka, si dhe organizime të tjera që realizojnë studime dhe shërbime.*
 - d. Njësitë administrative, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 13 të këtij Statuti.

Neni 10

Struktura e AU

1. Struktura organizative e AU si një IAL jo publik, me statusin e Universitetit është miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimim.
2. Kjo strukturë është objekt ndryshimi vetëm në funksion të llojeve dhe programeve të studimit që ajo ofron.
3. AU ka këto njësi përbërëse:
 - a. Rektorati;
 - b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
 - c. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
 - d. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Secila nga këto njësi ka strukturën e saj, si dhe ushtron veprimtari sipas përcaktimeve në këtë Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme të AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

4. Në strukturën organizative të AU, është edhe Dega e saj në Berat, e cila është pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore, në Tiranë.

Neni 11

Njësi të tjera në AU pranë Rektoratit

Pranë Rektoratit, si njësi të tjera në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor janë, dhe funksionojnë:

1. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike;
2. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
3. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave;
4. Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve;
5. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë;
6. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (tutoriati & mentorimi);
7. Zyra e Karrierës dhe Alumnit.

Veprimtaria e këtyre njësive rregullohet me Rregullore të vecanta që miratohen nga Senati i AU.

Neni 12

Njësi ndihmëse dhe shërbimi në AU

AU ka edhe këto njësi ndihmëse dhe shërbimi:

1. Sekretaria mësimore;
2. Bibliotekat universitare;
3. Laboratoret;
4. Klinika Stomatologjike Universitare;
5. Qendra sportive;
6. Qendra e shërbimit dhe e kulturës;
7. Shtëpia botuese “Albanian University Press”.

Veprimtaria e këtyre njësive rregullohet me Rregullore të veçanta që miratohen nga Senati i AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 13
Njësitë administrative

Në funksion të plotësimit të nevojave të njësive mësimore-shkencore e detyrimeve ligjore dhe fiskale të Universitetit si institucion jo publik, AU ka edhe këto njësi administrative:

1. Zyra e financës;
 - Zyra auditit të brendshëm.
2. Zyra e burimeve njerëzore;
3. Zyra informacionit;
4. Zyra e arshivës dhe protokollit;
5. Zyra e IT.

Mënyra e organizmit dhe funksionimit të këtyre njësive është në kompetencë të Bordit të Administrimit. Veprimtaria e këtyre njësive rregullohet me Rregullore të veçanta që miratohen nga Bordi i Administrimit të AU.

Neni 14
Organizimi i njësive kryesore - Fakulteteve

Fakultetet si njësi kryesore të AU janë të organizuara në këtë mënyrë:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore:
 - Departamenti i Stomatologjisë;
 - Departamenti i Farmacisë;
 - Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore:
 - Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative;
 - Departamenti i Shkencave Juridike;
 - Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike:
- Departamenti i Arkitekturës;
 - Departamenti i Inxhinierive;
 - Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Neni 15
Fakultetet

1. Fakultetet e AU:
 - (1) Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
 - (2) Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
 - (3) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Në zbatim të nenit 23 të Ligjit Nr. 80/2015 Fakultetet janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura, përkatësisht në shkencat mjekësore; në ato shoqërore dhe në shkencat e aplikuara dhe ekonomike.
2. Fakultetet në AU ofrojnë programe të cikleve të ndryshme të studimit, në përfundim të të cilave lëshohen diploma përkatëse, në përputhje me ciklet e studimit.
3. Fakultetet në AU, janë të organizuara në njësi bazë, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 14 të këtij Statuti. Këto njësi bazë janë të organizuara si Departamente, në secilin Fakultet.
4. Fakulteti drejtohet nga Dekani, i cili emërohet nga Senati Akademik, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 29, pika 3 të këtij Statuti.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 16
Departamenti

1. Departamentet, në Fakultetet e AU, në zbatim të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015”, janë njësi bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të Fakultetit.
2. Departamenti në AU përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.
3. Departamenti në AU është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
4. Departamenti në AU nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, për programet respektive të studimit që ofron.
5. Departamentet në AU ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre janë me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamentet kanë në përbërje të tyre dhe personel ndihmës akademik – asistentët e Departamentit.
6. Departamentit në AU i lind e drejta të organizohet në grupe mësimore dhe kërkimore-shkencore, të përhershme ose të përkohshme.
7. Departamenti në AU ka të drejtën e propozimit të programeve të studimit, si edhe të numrit të studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë, të parashikuara shprehimisht në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
8. Departamenti në AU ka të drejtën për të përcaktuar kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në respektim të kuadrit ligjor në fuqi.
9. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloret e Fakulteteve.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Pjesa Parë Organet Kolegjiale

Neni 17 Parim i përgjithshëm

Qeverisja e Albanian University bazohet në bashkëpunimin e organeve drejtuese dhe autoriteteve drejtuese në nivel universiteti, Fakulteti, Departamenti dhe njësive të tjera administrative. AU funksionon në bazë të Rregulloreve Institucionale të vendosura nga organet përkatëse.

Neni 18 Organet drejtuese dhe administruese

Organet drejtuese dhe administruese kolegjiale në AU janë: (1) Senati Akademik; (2) Rektorati; (3) Bordi i Administrimit; (4) Këshilli i Etikës; dhe (5) Komisionet e Përhershme.

Neni 19 Senati Akademik

1. Senati Akademik është organi kolegjial më i lartë akademik, në nivel Universiteti, dhe përbëhet nga anëtarë të personelit akademik, të cilët janë titullar të AU, të njësive kryesore, të njësive bazë, si dhe nga stafi akademik, dhe përfaqësues të Këshillit Studentor.
2. Senati është organ vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
3. Senati akademik kryesohet nga Rektori dhe mblidhet periodikisht.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

4. Senati akademik, në përcaktim të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 ushtron këto kompetenca kryesore:
- a. garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b. propozon planin strategjik të zhvillimit të AU dhe ia kalon për miratim Bordit të Administrimit;
 - c. miraton Statutin e institucionit të arsimit të lartë me 2/3 (dy të tretat) e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
 - d. propozon buxhetin vjetor dhe atë afat mesëm të AU, dhe ia kalon për miratim Bordit të Administrimit;
 - e. harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
 - f. miraton Rregulloren e Përgjithshme të AU, si dhe Rregulloret dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Statut;
 - g. miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
 - h. propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë, pasi ka marrë vlerësimin paraprak nga Bordi i Administrimit;
 - i. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit të arsimit të lartë mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, pasi ka marrë vlerësimin paraprak nga Bordi i Administrimit;
 - j. miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
 - k. miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore së institucionit, të hartuar nga Rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
 - l. zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
 - m. krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përherëshme përcaktuara, në nenin 25 të këtij Statuti;
 - n. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- o. krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
 - p. organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.
5. Kompetenca të tjera të Senatit të përcaktuara në këtë Statut janë:
- a. miraton vendosjen e marrëdhënieve në nivel kombëtar e ndërkombëtar me Institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të propozuar nga Fakultetet, në funksion të zhvillimit institucional dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencorë të AU;
 - b. propozon për dhënien e titullit “*Doctor Honoris Causa*”, personaliteve të ndryshme nga vendi dhe bota;
 - c. propozon tarifat e studimit, të propozuara nga Fakultet, dhe ia përcjell ato për miratim Bordit të Administrimit;
 - d. propozon politikat e vecanta për trajtimin financiar të kategorive të veçanta sociale, dhe të studentëve të ekselencës, dhe ia përcjell ato për miratim Bordit të Administrimit;
 - e. përcakton kriteret e pranimit për kandidatët në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të Dekanatit;
 - f. zgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës;
 - g. shqyrton dhe shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e Komisioneve të përhershme, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi.
6. Senati përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë, përfaqësues të grupeve të mëposhtme:
- a. Përfaqësues të personelit akademik: 18 (tëtmëbëdhjetë) anëtarë;
 - b. Përfaqësues të studentëve: 1 (një), kryetar i Këshillit Studentor të AU.
7. Mandati i anëtarit të Senatit është me kohëzgjatje 4- vjeçare dhe mbaron:
- a. Me mbarimin e afatit;
 - b. Me dhënien e dorëheqjes;
 - c. Me largimin nga AU;
 - d. Me mungesën pa arsye në 3 seanca radhazi;
 - e. Në raste paafësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- f. Në rastin e shkeljeve të rënda të Ligjit;
 - g. Në ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në organin drejtues;
 - h. Kur dënohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, e cila cënon rëndë figurën morale dhe integritetin e të qënurit 'pedagog'.
8. Me largimin e një anëtar të Senatit, në kushtet e parashikuara nga pika 7, e këtij neni zëvendësimi i tij bëhet nga personi që zë vendin në të drejtat dhe detyrat e tij, brenda 1 muaj nga dita e largimit.

Neni 20
Funksionimi i Senatit

1. Senati Akademik mbledhet në sesione të rregullta 3 (tre) herë në një tremestër. Sesionet e jashtëzakonshme thirren kur Rektori ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij e kërkojnë një gjë të tillë. Mbledhjet e Senatit bëhen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet e tij merren me shumicën e thjeshtë të votave, me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon ndryshe.
2. Senati në ushtrimin e funksionit të tij shprehet me vendime.
3. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit akademik, rendi i ditës, votimi dhe çështje të tjera të lidhura me to parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit.

Neni 21
Rektorati

1. Rektorati, në zbatim të nenit 40 të Ligjit Nr. 80/2015 është organ kolegjal ekzekutiv, që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a. Rektori;
 - b. Zëvendësrektor/ët – (1) Zv.Rektor për procesin mësimor; (2) Zv.Rektor për kërkimin shkencor.
 - c. Administratori i përgjithshëm i institucionit;
 - d. Dekanët e Fakulteteve të AU.
2. Funksionet kryesore të Rektoratit janë:



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të Administratorëve të njësive kryesore, dhe ja paraqet për miratim Senatit;
 - b. harton programin vjetor të veprimtarive mësimore, dhe kërkimore-shkencore, mbi bazë të propozimeve njësive bazë dhe kryesore si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit nga Senati akademik;
 - c. harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore pasi merr raportet individuale nga cdo njësi kryesore, dhe ia paraqet për miratim Senatit akademik;
 - d. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - e. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati akademik dhe Bordi i Administrimit;
 - f. monitoron veprimtarinë e AU dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij.
 - g. përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga Senati akademik;
 - h. ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e Universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të AU.
3. Rektorati kërkon mendimin e Senatit akademik dhe të Bordit të Administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
 4. Rektorati raporton një herë në semestër në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit për realizimin e planit të veprimtarive;
 5. Detyrat dhe funksionimi i Rektoratit, si dhe marrëdhëniet e Rektoratit me organet e tjera të Universitetit sanksionohen në Rregulloren e tij të Përgjithshme të hartuar në përputhje me këtë Statut.

Neni 22
Bordi Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Në Albanian University, si një Institucion jopublik i arsimit të lartë, me statusin e Universitetit veprimtaria e të cilit është fitimruese përbërja e Bordit të Administrimit



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

përcaktohet në planin buxhetor afatmesëm të Institucionit, miratuar nga vetë Bordi i Administrimit.

Bordi i Administrimit të AU përbëhet nga 7 anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë të Bordit të Administrimit emërohen nga Senati, të cilët janë pjesë e personelit akademik në AU, dhe 4 (katër) anëtarët e tjerë, emërohen nga Administratori i Shoqërisë Tregtare (SHT).

Mënyra e emërimit të tyre, rregullohet me Rregulloren e Bordit të Administrimit.

3. Mandati i anëtarëve të emëruar nga Senati është 5 vjet.
4. Në zbatim të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 Bordi i Administrimit të AU ushtron këto kompetenca kryesore:
 - a. garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b. me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - c. me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
 - d. me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit akademik në të gjitha nivelet;
 - e. vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - f. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
 - g. jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - h. përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - i. është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e Administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
 - j. emëron dhe shkarkon Administratorin e përgjithshëm të AU; Administratorët e njësive kryesore, si dhe personelin administrativ, mbi bazë të propozimeve të Administratorit të SHT;
 - k. miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare së institucionit, të hartuar nga Rektori.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

5. Kompetenca të tjera të Bordit të Administrimit janë:
 - a. i propozon Senatit ndryshime në nivelin e pagave si dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore;
 - b. I propozon Senatit, ndryshime në nivelin e tarifave të studimit;
 - c. I propozon Senatit, kategoritë sociale dhe bursat e ekselencës për çdo vit akademik, të cilët përfitojnë bursa studimi;
 - d. miraton Rregulloren e funksionimit të tij.
6. Anëtarësia në Bordin e Administrimit, në respektim të nenit 48, pika 6 të Ligjit Nr. 80/2015 është e papajtueshme me detyrën e Rektorit, të Dekanëve, të Përgjegjës të Departamentit, si dhe të Administratorit të përgjithshëm dhe Administratorëve të njësive kryesore.
7. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit përfundon:
 - a. Me mbarimin e afatit;
 - b. Me dhënien e dorëheqjes;
 - c. Me largimin nga Universiteti;
 - d. Me mungesën pa arsye në 3 seanca radhazi;
 - e. Në raste pa aftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - f. Në rastin e shkeljeve të rënda të Ligjit;
 - g. Me propozim të Administratorit të SHT, për anëtarët e emëruar nga ai/ajo;
 - h. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që cënon rëndë personalitetin dhe integritetin e tij dhe që lidhet ngushtë me ushtrimin e këtij funksioni.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Pjesa Dytë
Organe të tjera kolegiale

Neni 23
Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore - Fakultetit.
2. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore në AU ka këto funksione kryesore:
 - a. i propozon Senatit anëtarë nga personeli akademik që do të jenë pjesë në komisionet e përhershme të AU, të parashikuara në nenin 25 të këtij Statuti;
 - b. si dhe kompetenca të tjera, në përputhje me nevojat e institucionit.

Neni 24
Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës në AU vepron në nivel institucional dhe është organ kolegjal që diskuton probleme të etikës së jetës universitare.
2. Ai promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
3. Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhen nga Senati Akademik, mbi bazën e propozimit të Rektorit.
4. Anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të mbajnë titullin shkencor “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
5. Këshilli i Etikës së AU përbëhet nga 5 anëtarë.
6. Këshilli i Etikës harton Kodin e Etikës së AU si dhe Rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik.
7. Mënyra e veprimtarisë së Këshillit të Etikës në lidhje me shqyrtimin e ankesave, vendimet dhe sanksionet përkatëse si dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve parashikohen në Rregulloren e Këshillit të Etikës.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 25
Komisionet e përhershme

1. Pranë AU në rang institucional ngrihen dhe funksionojnë Komisionet e përhershme.
2. Komisionet e përhershme, në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr. 80/2015, janë organe kolegjinale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit.
3. Komisione të përhershme në AU janë:
 - a. Komisioni për dhënie të gradës “Doktor”;
 - b. Komisioni për Promovimin e personelit akademik për titujt shkencor “Prof.Asoc”, dhe “Prof.”, kur institucioni përmbush kushtet për ofrimin e tyre;
 - c. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin;
 - d. Komisioni për Vlerësimin Institucional;
 - e. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.
4. Secili nga këto komisione, ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët e këtyre komisioneve janë të zgjedhur nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje, mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e personelit akademik, sipas përcaktimeve të vendosura në nenin 23 të këtij Statuti.
5. Anëtarët e dy komisioneve të përcaktuar në gërmat a) dhe b) të pikës 3 të këtij neni, duhet të mbajnë titullin shkencor “Prof.”, dhe “Prof.Asoc.”.
6. Në komisionet e parashikuara në pikën 3, gërmat c), e), d) të këtij neni janë të përfaqësuar edhe studentet e Institucionit, të cilët zgjidhen nga Këshilli studentor.
7. Funksionet dhe organizimi i tyre përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni
Dekanati 26

1. Në AU, në zbatim të nenit 43 të Ligjit Nr. 80/2015, Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga:
 - a. Dekani;
 - b. Zëvendësdekani;
 - c. Administratori i njësisë kryesore;
 - d. Drejtuesit e njësive bazë – përgjegjësit e Departamenteve.
2. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të Administratorit të njësisë kryesore.
3. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë.
4. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik. Ata emërohen dhe shkarkohen nga Dekani, pas miratimit nga Rektori sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU.
5. Funksionet të tjera të e Dekanatit përcaktohen në Rregulloret e njësive kryesore.

Pjesa Tretë
Organet drejtuese individuale akademike

Neni 27
Autoritetet drejtuese

Autoritetet drejtuese në AU janë:

- a) Rektori;
- b) Dekani;
- c) Përgjegjësi i Departamentit



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 28
Rektori

1. Në AU në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 80/2015 , Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të këtij Ligji.
2. Në AU, Rektori emërohet nga Administratori i SHT, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë riemërimi, pa kufizim.
3. Rektori AU ka titullin shencor “Profesor”.
4. Rektori ushtron këto funksione:
 - a. drejton universitetin në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij akademike, dhe kërkimore shkencore;
 - b. drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij;
 - c. drejton hartimin e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, ia paraqet atë Senatit për miratim dhe ndjek zbatimin e tij;
 - d. paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t’u shqyrtuar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit apo Këshilli i Etikës së Institucionit;
 - e. nënshkruan, në emër të AU , marrëveshje e protokolle bashkëpunimi me universitetet e tjera, vendase dhe të huaja, dokumentacione për anëtarësimin e AU në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, marrëveshje bashkëpunimi me subjekte vendase dhe të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë. Këto marrëveshje, protokolle e bashkëpunime i paraqiten Senatit për ratifikim;
 - f. si përfaqësues ligjor i AU përfaqëson Institucionin në marrëdhënie me të tretët;
 - g. si kryetar i Senatit, ka të drejtën e vetos mbi vendimet e tij, duke ia kthyer këtij organi për rishqyrtim. Kur Senati, mbas rishqyrtimit, nuk e ndryshon vendimin, vendimi është i formës së prerë;
 - h. shfuqizon, kryesisht apo me kërkesën e të interesuarit, aktet e Dekanit, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi;
 - i. nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucion;
 - j. nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë për të deleguar nënshkrimin;
 - k. ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

5. Funksioni i Rektorit përfundon:
 - a. Me mbarimin e mandatit;
 - b. Me dhënien e dorëheqjes;
 - c. Me largimin nga Universiteti;
 - d. Në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - e. Me propozim të Administratorit të SHT, për raste të shkeljeve të rënda të parashikuara në Kodin e Etikës; ose në rastin e shkeljeve të rënda të Ligjit;
 - f. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që çëmon rëndë figurën dhe integritetin e në ushtrimin e këtij funksioni.
6. Në rastin e largimit të Rektorit, sipas pikës 5, gërmat b), c), d), e), f) të këtij nenit, Administratori i SHT komandon në detyrë një prej zëvendësrektorëve për një afat deri në 2 (dy) muaj, deri në emërimin e Rektorit të ri.

Neni 29
Dekani

1. Në AU në zbatim të nenit 42 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh”, drejtuesi i njësive kryesore është Dekani i Fakultetit.
2. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësive kryesore dhe përfaqësues i saj.
3. Në AU, Dekani propozohet nga Rektori, dhe emërohet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurrimi.
4. Dekani duhet të gëzojë titullin shkencor “Profesor”, ose “Prof.Asoc.”, ose gradën shkencore “Dr.” këtë të fundit të fituar në një nga universitetet e vendeve anëtare të OESD-së, ose BE-së.
5. Dekani emërohet për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
6. Dekani kryen këto funksione:
 - a. koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve të njësive kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
 - b. përgatit propozimin përkatës për çdo vendimarrje të njësive bazë;
 - c. përgjigjet para Senatit Akademik për mbarëvajtjen e aktivitetit të tij;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- d. i propozon Komisionit të përhershëm “Për kurrikulat dhe mësimin” hapjen apo mbylljen e programeve të studimit si dhe reformimin e kurrikulave, të Departamenteve apo njësive të veçanta në Fakultet;
 - e. i propozon Rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të Ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit;
 - f. i propozon Administratorit të përgjithshëm të AU shkarkimin e Administratorit të njësisë kryesore.
7. Dekani në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime dhe/ose udhëzime.
8. Marrëdhëniet e Dekanit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në Rregulloren e njësisë kryesore.

Neni 30

Përgjegjësi i Departamentit

- 1. Përgjegjësi i Departamentit është drejtuesi i njësisë bazë.
- 2. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë.
- 3. Përgjegjësi i Departamentit propozohet nga Dekani dhe emërohet nga Rektori në bazë të një procesi konkurrimi, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 4. Përgjegjësi i Departamentit, ka titullin shkencor “Profesor”, “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
- 5. Funksionet e përgjegjësit të Departamentit, përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU, si dhe në mënyrë të detajuar në Rregulloren e njësisë kryesore.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Pjesa Katërt
Organet drejtuese individuale administrative

Neni 31
Administratori i Përgjithshëm në AU

1. Në AU në zbatim të nenit 52 të Ligjit Nr. 80/2015 në rang Institucioni vepron Administratori i përgjithshëm i Institucionit.
2. Administratori i përgjithshëm i AU propozohet nga Administratori i SHT dhe emërohet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori kryen këto funksione:
 - a. harton projektbuxhetin vjetor, në bashkëpunim me zyrën e financës mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
 - b. propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
 - c. ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij;
 - d. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
 - e. i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
 - f. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të Administrimit të përditshëm;
 - g. propozon emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve të njësive kryesore në Bordin e Administrimit;
 - h. plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
4. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 32

Administratori njësisë kryesore - Fakultetit

1. Në AU në zbatim të nenit 53 dhe 54 të Ligjit Nr. 80/2015, në rang të organizimit të Institucionit, pranë njësisë kryesore vepron Administratori i saj.
2. Në AU Administratori i njësisë kryesore, propozohet nga Administratori i Përgjithshëm dhe emërohet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj.
4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Funksionet e Administratorit të njësisë kryesore janë:
 - a. realizon Administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;
 - b. mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;
 - c. plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - d. i raporton për veprimtarinë e tij Administratorit të përgjithshëm të AU, si dhe informon Dekanin, sipas përcaktimeve në Rregulloren e njësisë kryesore.
6. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në Rregulloret e njësive kryesore

KREU IV

PERSONELI

Neni 33

Personeli në AU

Personeli në AU përbëhet nga: (1) personeli akademik; (2) personeli ndihmës-akademik; dhe (3) personeli administrativ.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 34
Personeli akademik

Në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 58/1 të Ligjit Nr. 80/2015 “personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë.

Neni 35
Kategoritë e personelit akademik në AU

1. Në zbatim të nenit 59 të Ligjit Nr. 80/2015, personeli akademik në AU, kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në AU është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor.
3. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU dhe janë pjesë e kontratës individuale të punës mes palëve.
4. Personeli akademik në AU sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: (a) profesorë; (b) lektorë; dhe (c) asistent-lektorë.
 - a. “Profesorë” janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë titujt shkencorë “Profesor” ose “Profesor i asoc.”.
 - b. “Lektorë” janë anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, dhe kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit.
 - c. “Asistent-lektorë” janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

5. Numri i përgjithshëm i personelit në AU propozohet nga Senati Akademik, dhe miratohet nga Bordi Administrimit, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

Neni 36

Punësimi i personelit akademik

1. Marrëdhëniet e punësimit të personelit akademik të AU, rregullohen bazuar në kontratën individuale të punës, bazuar në legjislacionin e punës dhe atë të arsimit të lartë në fuqi.
2. Vendet e punës për personelin akademik, në AU fitohen nëpërmjet një procedure konkurruese.
3. Kriteret e konkurrimit, propozohen nga njësitë përkatëse bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i AU.
4. Kandidatët konkurrojnë në përputhje me afate e shpallura nga AU, të cilat bëhen publike në web site e universitetit : www.albanianuniversity.edu.al si dhe median elektronike.
5. AU, ndjek një procedurë për rekrutimin dhe shpalljen e kandidatit fitues, sipas rregullave të veçantë të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të AU.
6. Kontrata e punës, lidhet pa afat ose me afat të caktuar, sipas marrëveshjes individuale të palëve për të cilën ato kanë rënë dakort.
7. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në AU, në respektim të nenit 64/2 të Ligjit Nr. 80/2015 nuk mund të jetë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.
8. Anëtarët e personeli akademik të AU, kanë të drejtë të angazhohen me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të Departamentit dhe të Rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve të AL.

Neni 37

Personeli akademik i ftuar

1. Në funksion të mirëfunksionimit të procesit mësimor, njësitë bazë – Departamentet e AU kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës dhe/ose personalitete vendase ose të huaj, në fushat respektive të studimit në AU.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

3. Kriteria të detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar përcaktohen në Rregulloret e Përgjithshme të AU.

Neni 38

Personeli akademik me kontratë me kohë të pjesshme

1. AU ka të drejtë të thërrasë me kontratë me kohë të pjesshme personalitete vendase ose të huaja, për një periudhë të caktuar kohe, kohëzgjatja e të cilës në funksion të procesit mësimor është 1 (një) ose 2 (dy) semestra.
2. Ky personel rekrutohet me vendim të Senatit, sipas propozimeve të njësive kryesore të AU.
3. Kontrata nënshkruhet nga Rektori dhe ofruesi i punës/shërbimit duke respektuar rregullat e legjislacionin në fuqi.

Neni 39

Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik pas moshës së daljes në pension

1. AU, në respektim të nenit 65 të Ligjit Nr. 80/2015, lejon personelin akademik, që ka titullin shkencor “Profesor”, të ushtrojë funksionin e pedagogut deri në moshën 68 vjeç, dhe personelit akademik, që ka titullin “Profesor i asociuar”, deri në moshën 65 vjeç, me përjashtim në të dy rastet kur me kërkesën e tij largohet nga detyra.
2. AU, në funksion të nevojave të procesit mësimor dhe me pëlqimin e personit që mban titullin “Profesor”, edhe pas moshës 68 vjeç, dhe të atij që mban titullin “Profesor i asociuar”, edhe pas moshës 65 vjeç, nëshkruan një kontratë me një kohëzgjatje të caktuar deri më 1 (një) vit, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 40

Viti akademik sabatik

1. Personelit akademik, të kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” në AU, në respektim të nenit 63 të Ligjit Nr. 80/2015, i takon e drejta e vitit akademik sabatik një herë në shtatë vjet, për një periudhë kohe deri në një vit.
2. Departamenti dhe pas tij njësia kryesore jep/ose jo miratimin për kryerjen e viti akademik sabatik.
3. Kandidati/ja paraqet në Departament projektin e tij/saj dhe periudhën gjatë së cilës ai/ajo do të ushtrojë të drejtën e vitit sabatik.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

4. Në përfundim të vitit akademik sabatik, punonjësi akademik paraqet në Departament raportin përfundimtar të aktivitetit të kryer.

Neni 41
Norma mësimore

1. AU, në përcaktimin e normës vjetore mësimore dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore për çdo kategori të personelit akademik, respektohen kriteret ligjore të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsim.
2. Çështje të tjera që kanë të bëjnë me kohën e punës dhe të pushimit përcaktohen në Kontratën Individuale të Punës, dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi.

Neni 42
Detyrimi i promovimit akademik dhe shkencor

1. Personeli akademik në funksion të promovimit të tij, si dhe të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor të Institucionit, në fillim të çdo viti akademik duhet të paraqesë në Departamentin përkatës planin e veprimtarisë së tij shkencore - botimeve për tekste, artikuj, monografi, planin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit.
2. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, ai është i detyruar të paraqesë një raport të përmbushjes së planit të veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore.

Neni 43
Personeli ndihmës - akademik

1. Personeli ndihmësakademik në AU përbëhet nga: (1) personeli ndihmësakademik me karakter mësimor; dhe (2) personeli ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit të punës në fuqi.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 44

Personeli ndihmës - akademik me karakter mësues

1. Personeli ndihmës - akademik me karakter mësues ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. `
2. Në kategorinë e këtij personeli bëjnë pjesë: laborantët, asistentët e Departamenteve, si dhe asistent pedagogët për praktikantët mësues, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU.

Neni 45

Personeli ndihmësakademik me karakter administrative

1. Personeli ndihmës - akademik me karakter administrative në AU ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel Institucion, Fakulteti dhe Departamenti.
2. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i Sekretarive mësues, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU.

KREU V

STUDENTI DHE TË DHËNAT PËR STUDENTËT

Neni 46

Statusi student

1. Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin në AU dhe e humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Rastet e çregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e AU.
2. Një student në AU, nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky rregull, studentët ‘e shkëlqyer’ me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.
3. Çdo student, ka të drejtë që të kërkojë pezullimin e studimeve të tij, në përputhje me rregullat e parshikuara shprehimisht në Rregulloren e Përgjithshme të AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 47
Të drejtat e studentëve

1. Studentët në AU kanë të drejtët si mëposhtë:
2. Të marrin pjesë në vendimarrjen e AU, dhe përfaqësohen në Këshillin Studentor, Senat dhe Komisionet e përherëshme, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 25, të pikës 3 të këtij Statuti;
3. Të shprehin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të AU;
4. Të ndjekin leksione, seminare/ushtrime dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore dhe shkencore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
5. Të përdorin infrastrukturën (salla leksiones/seminares, laboratore, salla kompjuterash, bibliotekën, etj) që AU vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen për studentët në AU;
6. Të nënshkruajnë kontratën e shërbimi, në momentin e regjistrimit në AU. Elementet e kontratës dhe forma e saj përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;
7. Të organizohen në shoqata studentore që nuk kryejnë veprimtari politike dhe ekonomike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;
8. Të pajisen nga MAS me Kartën e Studentit, që është dokument unik, me anë të së cilës përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen nga Ministria përgjegjëse për arsim;
9. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Bordi i Administrimit.
10. Çdo student ka të drejtë të pajiset me një numër unik matriculimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, që regjistrohet në “Regjistrin themeltar të studentëve”, që lëshohet nga ministria përgjegjëse për arsim.
11. Çdo studentet, ka të të drejtë që të marrë rezultate e arrira, në cdo program studimi. Keto rezultate, pasqyrohen në formë të shkruar në “Regjistrin e arritjeve akademike”.
12. Çdo studentët në përfundim të programit të studimit, ka të drejtë të pajiset me diplomën dhe shtesën e diplomës, në përputhje me programin e studimit të kryer.
13. Për studentët, që studiojnë në programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, AU realizon sigurimin në një ndër shoqëritë e sigurimit, për riske që mund të vinë për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të programit përkatës të studimit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 48
Detyrimet e studentit

1. Studentët në AU kanë për detyrë:
 - a. të zbatojnë rregullat e parashikuara në Rregulloren e AU;
 - b. të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron AU;
 - c. të respektojnë Kodin e Etikës së AU;
 - d. të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
 - e. të respektojnë përmbushjen e detyrimeve mësimore, si dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike të AU.
2. AU nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e detyrimeve, nga studenti.

Neni 49
Këshilli studentor

1. Në AU, studentët organizohen në Këshillin Studentor, i cili është një organizëm i pavarur, që nuk zhvillon aktivitet politik dhe ekonomik.
2. Ky Këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AU, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.
3. Këshilli Studentor zgjidhet çdo dyt vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.
4. Këshilli Studentor nuk katë drejtë të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë AU.
5. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në rregulloren e brendshme të këtij Këshilli, e cila hartohen në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin Nr. 80/2015 «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh» mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.
6. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të AU, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetorë paraprake të



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj

7. AU mbështet Këshillin Studentor dhe financon veprimtarinë e tij.

Neni 50

Dokumentacioni i procesit mësimor në funksion të studentëve

1. Pranë AU, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015 “ Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh”, krijohet dhe mbahet në formë të shkruar dhe elektronike, ky dokumentacion i cili përbëhet nga:
 - a. *Regjistrin themeltar i studentëve*, i cili është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në AU, ku cdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër;
 - b. *Regjistri i arritjeve akademike*, i cili është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në AU, sipas programeve të studimit.
 - c. *Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave*, i cili është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej AU, ku vërtetohet se cdo student ka tërhequr diplomën dhe suplementin e saj, më përputhje me titullin e arrirë pasi ai ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale.
2. AU, ka detyrimin ligjor që të tre këto regjistra, të parashikuara në pikën 1, gërmat a), b), c) të këtij neni pas plotësimit përfundimtar të tyre, sipas rregullit të parashikuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 80/2015 t’i depozitojë në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njëzuar me origjinalin të ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit.
3. Këto regjistra shpërndahen nga Ministria përgjegjëse për arsim.

Neni 51

Baza e të dhënave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë

1. Në zbatim të nenit 101 të Ligjit Nr. 80/2015, AU është e detyruar të ruajë të dhënat personale të studentëve.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga AU kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DHE TITUJT

Neni 52

Format e studimit

1. Format e studimeve në AU janë:
 - a. studime me kohë të plotë;
 - b. studime me kohë të zgjatur;Studimet me kohë të zgjatur në AU ofrohen vetëm në programet studimit të ciklit të dytë “Master profesional”.
2. Realizimi i secilës nga format e mësipërme të studimit bëhet, sipas propozimit të AU, me miratim të Ministrisë përgjegjëse për arsim, në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri.

Neni 53

Programet e studimeve

1. AU ofron programe studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.
3. Programet e studimeve universitare hartohen nga Fakultetet dhe miratohen në Senatin akademik të AU. Ato hartohen në përputhje me kërkesat e neneve 73, 75, 77 të Ligjit Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. Programet e studimit të ofruara nga AU janë në përputhje me nivelet 6, 7 dhe të 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5. Programet e studimeve shpallen publikisht para fillimit të aplikimeve për pranimet në AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

6. Cdo program studimi ka strukturën dhe përmbajtjen e tij, të cilat hartohen konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin e lartë.
7. Mënyra e organizmit të çdo programi studimi, përcaktohet në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e njësisë kyesore, dhe përmbajtja e tyre në Rregulloren përkatëse të cdo programi studimi.

Neni 54

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet universitare në AU zhvillohen me bazë vitin akademik.
2. Data e fillimit të vitit akademik shpallet nga Ministri i Arsimit.
3. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë mësim.
4. Çdo javë ka të paktën 20 -25 orë mësimpre – leksione/seminare/ laboratorë; struktura e të cilave përcaktohet në programet e studimeve përkatëse.
5. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar. Në këtë drejtim, AU respekton standartet e përcaktuara në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e Ministrit përgjegjës për arsimin, të cilat pasqyrohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Përgjithshme të AU, dhe në Rregulloren e vecantë të cdo programi studimi.

Neni 55

Programet e studimit dhe titujt e diplomave në AU

1. Programet e studimeve në AU organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.
2. Struktura e studimeve në cikle të ndryshëm studimi dhe titujt e diplomave të fituara me përfundimin e tyre janë në përputhje me përcaktimet përkatëse në Ligjin nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Programet e studimit, për cdo cikël studimi hartohen në përputhje me standartet e parashikuara në Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, në respektim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve , dhe duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe punësimin e ardhëshëm të studentëve.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

4. Në AU me përfundimin e studimeve të cikleve përkatëse lëshohen diplomat e studimit, në varësi të cikleve të studimit: (1) Bacheror; (2) Master Profesional; (3) Master i Shkencave; (4) Doktoraturë; dhe (5) Specializime afatgjata.

Neni 56

Pranimet në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve

1. Pranimi i studentëve në cikle të ndryshme të studimit në AU bëhet në përputhje me përcaktimet ligjore të përgjithshme të parashikuara shprehimisht në nenet 74, 76, 78 të Ligjit Nr. 80/2015 për cdo cikël studimi.
2. AU mund të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Fakultete të ndryshme të tij. Këto kritere i dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsim.
3. Departamentet në AU, kanë të drejtë të propozojnë kriteret për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në përputhje me përmbajtjen e programit të studimit, dhe me standardet shtetërore të cilësisë.
4. Programet e studimit, dhe kriteret për cdo program studimi miratohen nga Senati akademik.
5. Kriteret e pranimi të studentëve për cdo program studimi bëhen publike nga AU, në web site zyrtar të saj: www.albanianuniversity.edu.al

Neni 57

Programet e integruara të studimit në fushën e Stomatologjisë, Farmacisë dhe Arkitekturës

1. AU ofron programe të integruara të studimit në Stomatologji, Farmaci, dhe Arkitekturë.
2. Programet e studimit në Stomatologji, Farmaci, dhe Arkitekturë realizohen me 300 ECTS, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

Neni 58

Kodifikimi i programeve të studimit

AU ofron programe studimi të kodifikuara, kodifikimi i të cilave bëhet nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me kërkesat e nenit 86 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh”.

Neni 59



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Gjuha e studimeve

1. Gjuha e studimit të programeve të studimit të ofruara nga AU, është gjuha shqipe.
2. Programe të caktuara studimi, mund të ofrohen edhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit nga ministria përgjegjëse për arsim.
3. Studentët e AU, që regjistrohen në një program studimi në gjuhë të huaj, duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar nga institucioni në Rregulloren e këtij Programi Studimi.

Neni 60

Kohëzgjatja e studimeve në AU

1. Kohëzgjatja e studimeve në AU, për çdo cikël studimi dhe në çdo program studimi bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 90 i Ligjit Nr. 80/2015.
2. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
3. Kriteria më të hollësishme, parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU, dhe në Rregulloret e Fakulteteve.

Neni 61

Transferimi i studimeve

1. AU ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik në Fakultete të ndryshme brenda AU.
2. AU, u mundësohen studentëve njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve edhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në AU.
3. Kriteret dhe procedurat e hollësishme të transferimeve përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU, dhe në Rregulloret e Fakulteteve.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 62

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Të drejtën për të ndekur një program të dytë studimi të të njëjtit cikël në AU, e kanë të gjithë ata studentë të cilët kanë përfunduar një program studimi.
2. Në çdo Fakultet, komisioni përkatës për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve përcakton lëndët dhe detyrimet që duhet të realizojë kandidati që kërkon ndjekjen e një programi të dytë të studimeve.
4. Vendimin për ndjekjen e një programi të dytë studimi, merret nga Rektori mbi bazë të propozimit të Dekanit të njësisë kryesore përkatëse.
5. Një student në AU, nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky rregull, studentët ‘e shkëlqyer’ me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.

Neni 63

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. AU ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 81 të Ligjit Nr. 80/2015 , si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës.
2. AU ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.
3. Programet e studimeve të formimit të vazhduar, kohëzgjatja, organizimi i mësimdhënies dhe kreditet e tyre propozohen dhe hartohen në Departamentet që mbulojnë këto programe studimi.
4. Programet miratohen nga Këshilli i Fakultetit dhe nga Senati i AU.
5. Në përfundim të këtyre programeve, studenti duhet të ketë grumbulluar një numër të nevojshëm kreditesh, mbi bazën e të cilave lëshohet edhe Çertifikata përkatëse, firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 64

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomes

1. Studenti në përfundim të një programi studimi në AU, në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 80/2015, ka të drejtë të pajiset me diplomën përkatëse e cila shoqërohet me suplementin e diplomës.
2. Suplementi i diplomës, është i detyrueshëm, për të tre ciklet e studimit, të ofruara nga AU.
3. AU, ka të drejtë që të pajisë studentin me diplomë, vetëm pasi ajo të jetë regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
4. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës, i referohet ciklit të studimit dhe programit të studimit respektiv.
5. Në Rregulloren e AU, parashikohen në veçanti, natyra, niveli, përmbajtja dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fusha e punësimit.
6. AU, në funksion të studimeve që studeni ka kryer, ka të drejtë të lëshojë edhe certifikata, duke respektuar kriterin e vendosur nga neni 63, pika 5 e këtij këtij Statuti.
7. Diploma dhe suplementi i diplomës firmosen nga Dekani dhe Rektori.

KREU VII

SIGURIMI I CILËSISË

Neni 65

Organizimi strukturor

AU është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse të saj. Pranë AU, ngrihet dhe funksionon struktura e cilësisë, pjesë përbërëse të të cilës janë:

- a. Komisioni për vlerësimin Institucional;
- b. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 66

Komisioni për vlerësimin institucional

1. Komisioni për vlerësimin institucional ngrihet pranë Rektoratit të AU, në përbërje të tij janë 5 anetë të cilët zgjidhen nga Senati, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij Statuti.
2. Komisioni mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në HEAL është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU.
3. Komisioni harton rregulloren e funksionimit të tij si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse, e cila miratohet nga Senati.
4. Komisioni kontrollon veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mbi bazën e një raporti periodik 6 mujor nga kjo e fundit.
5. Bordi Administrimit përcakton në buxhetin e institucionit, mbi bazën e propozimit të Komisionit për vlerësimin institucional fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë.

Neni 67

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC) planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë: (1) të programeve të studimit, dhe (2) vlerësimin të brendshëm të institucionit.
2. ZSBC për cdo vlerësim që organizon, nge Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor, dhe kur e shikon të arsyeshme ajo fton edhe një ekspert të jashtëm.
3. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet në rang Fakulteti, dhe në veprimtarinë e tij ai ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
4. GVB e realizon veprimtarinë e tij bazuar në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në HEAL .
5. GVB në veprimtarinë e tij realizon: analiza statistikore të të dhënave, bazuar në të dhënat e evidentuara në regjistrat sipas përcaktimit të nenit 50 të këtij Statuti, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuar me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët.
6. Të dhënat e vlerësimit, ZSBC i publikon në faqen zyrtarë të AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

7. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional organizohet nga ZSBC si rregull një herë në 3 vjet. Nëse është e nevojshme, ZSBC mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh.
8. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.
9. ZSBC në bashkëpunim me Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) organizon trajnim të anëtarëve të grupit të vlerësimit. Për anëtarët e grupit të vlerësimit njësia merr masat e sigurimit të kushteve të përshtatshme për realizimin e kësaj detyre.
10. ZSBC mban lidhje të vazhdueshme me ASCAL për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në AU.

KREU VIII

KËRKIMI SHKENCOR DHE SHËRBIMET

Neni 68

Kërkimi shkencor në AU

1. AU synon që kërkimi shkencor të jetë pjesë e integruar e veprimtarisë së tij.
2. AU synon që nëpërmjet kërkimit shkencor të rrisë shkallën e kualifikimit të stafit të saj akademik.
3. AU synon që nëpërmjet kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesmarrjes në studime dhe projekte me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar të krijohen burime të tjera financimi të ligjshme për veprimtarinë e AU .
4. AU synon tu ofrojë studentëve aftësi dhe njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore, të metodave dhe teknikave bashkëkohore.
5. Veprimtaria kërkimore –shkencore është pjesë e planit të punës të cdo njësie përbërëse në AU.
6. Në fillim të cdo viti akademik, stafi akademik ka detyrimin e planifimit dhe të raportimit të veprimtarisë shkencore, në funksion të kërkimit shkencor, sipas përcaktimit të nenit 42 të këtij Statuti.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 69

Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore-shkencore

1. Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të AU të programeve dhe projekteve të miratuara nga Senati Akademik.
2. Programet e studimeve të ciklit të tretë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit shkencor.
3. Brenda muajit tetor të çdo viti, njësitë kryesore të AU, dorëzojnë pranë Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin një raport për planifikimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore për vitin pasardhës, i cili bën edhe vlerësimin e performancës së tij, dhe ja kalon për miratim Senatit.
4. Veprimtaria e këtij Komisioni, në funksion të kërkimit shkencor Rregullohet me Rregullore të vecantë.

KREU IX

PRONAT DHE ADMINISTRIMI

Neni 70

Autonomia financiare

Në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh” (neni 108/2), AU harton planin buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.

Neni 71

Pronat në administrim të AU

AU, ka në Administrim këto prona :

1. Godina e Ish Estrades, Bulevardi Zogu I, Tiranë;
2. Ish Hotel Adriatik, Rr. Kavajës, Tiranë;
3. Ish Hotel Internacional, Rr.Kajo Karafili, Tiranë;
4. Ish Universiteti Amerikan i Tiranës, Rruga Tiranë Elbasan, Km 5, Lundër, Tiranë;
5. Ish Gjykata, Rr. Durrësit, Tiranë;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

6. Godina Sun Tower, Bisnes Center, Kati IV Rr. Kavajës, Tiranë;
7. Godina e Beratit, Lagjia 10 Korriku, Berat;
8. Godina e Fierit, Rruga “Lagjia Kastriot”, Fier.

Neni 72

Të ardhurat e krijuara nga AU dhe përdorimi i tyre

1. Të ardhurat që krijohen nga AU përbëhen nga:
 - a. të ardhurat nga finacimi i ortakut të vetëm të asamblesë së ortakut;
 - b. të ardhurat nga tarifat e studimeve;
 - c. të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
 - d. të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim për palët e treta në formën e kontratave të qiradhënies apo me forma të tjera kontraktimi;
 - e. të ardhura nga financimet e pakthyeshme të marra nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
 - f. të ardhura nga dhuratat, grantet e donacionet publike;
 - g. të ardhura nga financime të tjera të ligjshme.
2. Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen në llogarinë e AU. Mënyra e përdorimit të tyre përcaktohet në Rregulloren e Bordit të Administrimit.

Neni 73

Tarifat e studimeve

Tarifa e studimeve përbëhet nga tarifa e shkollimit.

Këto tarifa propozohen nga Senati, dhe miratohen nga Bordi i Administrimit sipas përcatimeve të bëra në nenin 19, pika 5, gërma c); dhe nenit 22, pika 5, gërma b) të këtij Statuti.

Mbi bazë të propozimit të Bordit të Administrimit përcaktohen kategorite sociale për cdo vit akademik, te cilët përfitojnë bursa studimi, si dhe studentët e ekselencës.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 74
Hartimi buxhetit

Projektbuxheti i AU hartohet nga Rektorati duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3- vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga njësitë përbërëse të AU.
Projektbuxheti të hartohet nga Senati Akademik dhe të miratohet nga Bordi i Administrimit.

Neni 75
Financime të tjera të AU

AU dhe njësitë përbërëse të saj mund të konkurrojnë me programe dhe projekte specifike të publikuara nga administrata shtetërore, nga entet publike ose private si dhe, pranë institucioneve ndërkombëtare.
Për të inkurajuar pjesëmarrjen në këto projekte hartuesit e projekteve shpërblehen në përputhje me përcaktimet e vendosura në Rregulloren e Bordit të Administrimit.

Neni 76
Granti i punës kërkimore-shkencore

Në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh” (neni 113), AU ka të drejtë të aplikojë pranë AKKSHI për marrjen e Grantit të punës kërkimore-shkencore, ku bëjnë pjesë edhe fondet për kërkimin shkencor.
Ky grant bën të mundur edhe sigurimin e fondeve për studimet e doktoratës, mbi bazën e aplikimit, nga ku përjashtohen financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

Neni 77
Fondi ekselencës

Për të nxitur veprimtarinë mësimore dhe shkencore të studentëve, krijimin e shembujve, praktikave dhe modeleve të punës së mirë, Rektorati në bashkëpunim me Dekanet e Fakulteteve përkatëse krijojnë ‘fondin e ekselencës’ me emërtime dhe shpërblime përkatëse.
Masa e shpërblimit të ‘fondit të ekselencës’ për cdo kategori përfituese miratohet nga Bordi i Administrimit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 78

Fondi i kategorive sociale

Në mbështetje të studentëve në nevojë, Rektorati në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve përkatëse, krijojnë ‘fondin e kategorive sociale’ me emërtime dhe shpërblime përkatëse. Masa e shpërblimit për cdo kategori sociale në nevojë miratohet nga Bordi i Administrimit çdo vit.

Neni 79

Fondi i promovimit

Në buxhetin e AU parashikohet fondi i promovimit. Ky fond përdoret për të promovuar produktet dhe aktivitetet e AU.

Masa e këtij fondi miratohet nga Bordi i Administrimit dhe mënyra e përdorimit përcaktohet në Rregulloren e Bordit të Administrimit.

Neni 80

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në AU realizohet nga zyra e auditit të brendshëm, e cila ngrihet dhe funksionon pranë Zyrës të Financës.

Fusha e veprimit të kësaj njësie dhe funksionimi i saj bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zyra e Auditit të brendshëm varet Bordi Administrimit.

Neni 81

Kontrolli dhe auditimi i jashtëm

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, të parashikuara në nenin 116/2 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh”, kontrolli dhe auditimi i jashtëm në AU kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 82

Kodifikimi i programeve të studimit

AU, në zbatim të nenit 125 të Ligjit Nr. 80/2015 brenda vitit akademik 2016-2017 , do të realizojë kodifikimin e programeve të saj të studimit.

Procedurat për kodifikimin e programeve ekzistuese dhe për riorganizimin e tyre do respektojnë udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 83

Riorganizimi i Programeve të studimit në drejtësi dhe mësuesi

1. AU, në zbatim të nenit 82 dhe 124, pika 7 të Ligjit Nr. 80/2015, do të riorganizojë programet e studimit në drejtësi, të cilat do të ofrohen si programe të integruara studimi, duke filluar nga viti akademik 2017-2018.
2. AU, në zbatim të nenit 83 të Ligjit Nr. 80/2015 do të riorganizojë Programin e studimit në mësuesi, duke filluar nga viti akademik 2017-2018.

Neni 84

Riorganizimi institucional

AU, në zbatim të nenit 129, pika 1, gërma c të Ligjit Nr. 80/2015 do të riorganizojë strukturën e tij të brendshme akademike dhe administrative, brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.

Neni 85

Emërimi i organeve drejtuese

AU, në zbatim të nenit 131 të Ligjit Nr. 80/2015 do të realizojë emërimin e organeve të saj drejtuese brenda vitit akademik 2016-2017.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Neni 86
Programet e doktoraturës

AU, në zbatim të nenit 134 të Ligjit Nr. 80/2015 për studentët, të cilët kanë nisur programet e studimit të doktoratës para hyrjes në fuqi të këtij Ligj, respekton detyrimin ligjor që këto programe do përfundohen sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës kur këta studentë janë pranuar.

Neni 87
Rregulloret

Në zbatim të këtij Statuti hartohen, brenda vitit akademik 2016-2017, Rregulloret e mëposhtme:

1. Rregullorja Përgjithshme e AU;
2. Rregulloret e Njësive Kryesore;
3. Rregullorja e funksionimit të Senatit Akademik;
4. Rregullorja e funksionimit të Bordit të Administrimit;
5. Rregullorja e Rektoratit;
6. Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Etikës Akademike;
7. Rregullorja për sigurimin e sistemit të cilësisë;
8. Rregulloret e Komisioneve të përhershme të posacme;
9. Rregulloret e tjera, të parashikuara shprehimisht në nenet përkatëse të këtij Statuti.

Neni 88
Stema dhe vula

1. Albanian University ka stemën dhe vulën e vet zyrtare, të cilat i bashkëngjiten këtij Statuti.
2. AU ka faqen e tij të internetit me adresë www.albanianuniversity.edu.al e cila administrohet nga AU.

Kryetari Senatit
Rektori

Prof.Dr. Vera Ostreni